

10.12.2001

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА ASSEMBLY OF KOSOVO

Me datën 10.12.2001 në ora 11 u mbajtë mbledhja inaguruese e Kuvendit të Kosovës .
Mbledhjen e hapi PSSP i Organizatës së Kombeve të Bashkuara z.Hans Hakerup i cili lajmëroj këtë :

RENDE DITE

1. Fjala e ushtruesit të detyrës së Kryesuesit lidhur me konstituimin e Kuvendit
2. Zgjedhja e Kryesisë së Kuvendit
3. Fjala zyrtare e hapjes e Kryetarit të Kuvendit
4. Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës

Fjala e ushtruesit të detyrës së Kryesuesit lidhur me konstituimin e Kuvendit

Në fjalën hyrëse z. Hakerup i përshëndeti deputetët dhe të gjithë të pranishmit dhe njëherit lexoi një mesazh të dërguar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara Kofi Anan dërguar popullit të Kosovës.

Zgjedhja e Kryesisë së Kuvendit

Zt.Hakerup bazuar në Kornizën Kushtetuese neni 9.1.7 për zgjedhjen e Kryesisë së Kuvendit ftoi përfaqësuesit e partive apo koalicioneve partiake që të emërojnë kandidatët për Kryesi të Kuvendit.Bazuar në Kornizën Kushtetuese neni9.1.7.a,b,c, ç dhe d , për numrin e kandidatëve që duhet ti emrojnë në bazë të votave të fituara në zgjedhjet për Kuvend.

Së pari u ftua zt. Ibrahim Rugova si përfaqësues i LDK –së i cili emëroi:

- a - Nexhat Dacin - Kryetar
- b - Fatmir Sejdiun - Anëtar

Në emër të PDK-së foli z. Fatmir Limaj i cili lajmëroj se partia e tyre nuk i kishte të gatshëm emrat e anëtarëve të Kryesisë.

Në emër të Koalicionit Kthimi foli zj.Rada Trajkoviç e cila emëroi :

- a - Gojko Savić
- b - Oliver Ivanović

Në emer të minoriteteve foli z.Zylfi Merxha i cili emëroi tre kandidat :

- a-Zylfi Merxha
- b-Nafiye Gas
- c-Dzezair Murati

Në bazë të marrveshjes së komuniteteve të tre këta kandidat do të jenë antar të kryesisë nga një vitë dhe së pari do të jetë Zylfi Merxha si përfaqësues i komunitetit Romë, vitin e dytë do të jetë Nafiye Gas si përfaqësuese e komuniteti Turk dhe vitin e tretë do të jetë Dzezair Murat si përfaqësues i komunitetit Boshnjak.

Pas emërimit të kandidatëve z.Hakerup ftoi deputetët që të votojnë:

- 119 deputet të pranishëm
- 78 deputet votuan për
- 3 deputet votuan kundër
- 2 deputet apstenuan

Pas zgjedhjes së Kryesis mori fjalen Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci i cili i përshëndeti të pranishmit dhe mbledhja u nderpre që të vazhdoj më 13.12.2001

SHËRBIMI JURIDIK I KUVENDIT

**10.12.2001
PRISHTINË**